



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën c. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr.03/L-025, nenit 5 të Ligjit për Vlerësim të Ndikimit në mjedis, Nr.03/L-214, në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MMPH-or për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, Nr.10/2012, si dhe nenit 10 parag.1 pika 3 e Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt, të mbajtur më 30.01.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

**Lëshuarje në diskutim publik të Projekt-rregullores për dhënien e lejes
mjedisore komunale**

I

Lëshohet në diskutim publik, Projekt-rregullorja për dhënien e lejes mjedisore komunale.

II

Projekt-rregullorja për dhënien e lejes mjedisore komunale, si në pikën 1 të këtij vendimi lëshohet në diskutim publik 15 ditë prej ditës së shpalljes në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e Komunës.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe organizatat e biznesit, si dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin tekstin e Rregullores në Zyrën ligjore në objektin e Komunës, si dhe vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të jepen pranë kësaj zyre.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve, Zyrës për Informim, Zyrës Ligjore dhe Radio-“ALBA”.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-769 /2015
Klinë, më 04.02 /2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi